

ZGJEROHET FAMILJA E SHKOLLAVE TË GJELBRA



Green Schools Si rezultat prej suksesit të arritur në vitin shkollor 2008-2009, si dhe për shkak të interesit të rritur gjatë pilot-fazës, u mori vendim që numri i tyre të zmadhohet dhe të përfshihen edhe 15 shkolla të tjera gjatë vitit 2009-2010. Në Shkollat e gjelbra shtese u formuan edhe Klube të gjelbra me numër mesatar prej 25 anëtarësh, fokusi i të cilave është përqendruar mbi katër tema të rëndësishme për mjedisin jetësor: efikasiteti energjetik, kursimi i ujit, ulje e mbeturinave dhe promovim i transportit ekologjik.



Shkollat e pilot-fazës janë:

1. Grigor Prliçev – Ohër
2. Vidoe Podgorec – Strumicë
3. Goce Dellçev – Negotinë
4. Mirçe Acev – Gjorçe Petrov
5. Drita – Saraj

15 shkolla nga faza e dytë janë:

6. Faik Konica – Zajaz
7. Aleksandar Zdravkovski – Jegunovcë
8. Koço Racin – Kratovë
9. Sabedin Bajrami - Bogovinjë
10. Ismail Qemali – Tearcë
11. Goce Dellçev - Vinicë
12. Sande Shterjoski - Krçovë
13. Blazhe Koneski - Prilep
14. Nikola Petrov Rusinski - Berovë

15. Joakim Krçoski – Gjorçe Petrov
16. Svetozar Markoviq – Nagoriçan i Vjetër
17. Peco Daskalot - Dollneni
18. Aleksandar Urdarevski – Çučer Sandevë
19. Debarca – Debarcë
20. Lazo Micev-Rale – Kavadarci



Deri në fund të shtatorit të 2010, u përfundua distribuimi i pajisjes së porositur nëpërmjet programit për Shkollat e gjelbra, që u zhvillua në bashkëpunim me partnerin tonë MDC.Ti.Net. Bashkëpunimi me MDC.Ti.Net përfundoi në mënyrë të suksesshme me atë që u arrit numri prej 20 Shkollave të gjelbra, të cilat tani po e përdorin doracakun dhe librin pune për Shkolla të gjelbra.



Duke filluar prej nëntorit 2010, u kyçëm në aktivitetin tashmë të filluar, i cili implementohet nga ana e OHO dhe Agjensisë zviceriane për zhvillim dhe bashkëpunim (SDC), dhe është i përkrahur nga Ministria për arsim dhe shkencë të RM-së. Ky do të jetë një program shumë më të gjerë dhe do t'i përfshijë të gjitha shkolla fillore e të mesme, si dhe të gjitha institucionet parashkollore të shtetit. Programi do të implementohet në 3 faza. Në fazën e parë do të kyçen 1/3 prej të gjitha shkollave fillore dhe të mesme dhe institucioneve parashkollore në Maqedoni. PEP do të kontribuojë me

shtypje të 4,000 kopjeve të "Eko kalendarit" dhe 4,000 kopjeve prej doracakut "Këshilla për planetë të shëndoshë". Tirazhi total i materialeve të shtypura në kuadër të këtij programi është 14,000 kalendarë dhe 14,000 doracaqe.



Programi Shkolla të gjelbra do ta vazhdojë bashkëpunimin me OHO dhe Agjensinë zviceriane për zhvillim dhe bashkëpunim (SDC), të përkrahur prej Ministrisë për arsim dhe shkencë.

Do të implementohen aktivitetet në vijim:

- shtypje e postereve dhe kanatjerave gjatë ditëve të ekologjisë
- krijim i lojërave për fëmijë me tema nga fusha e ekologjisë dhe mbrojtje të mjedisit jetësor
- trajnim për arsimtarët

Deri tani Shkollat e gjelbra punojnë kah këto synime:

1. rritjen e vetëdijes të fëmijëve, arsimtarëve dhe të rethit më të gjërë për mjedisin,
2. përpunim i çështjeve për mjedisin në programet shkollore,
3. përfshirje e arsimit për mjedis jetësor nëpër shkollat dhe
4. organizim dhe implementim të projekteve ekologjike në shkollën dhe në komunitetin.

Nxënësit tashmë kanë formuar edhe Klube të gjelbra dhe punojnë mbi aktivitete shtese me qëllim që të promovohen sjellja pozitive dhe mënyrë ekologjike e jetesës për nxënësit, stafit shkollor dhe mjedisit më të gjërë.